

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 5 Prot.

Tiranë, më 13/05/2020

VENDIM
Nr. 3 datë 13.05.2020

PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË QENDRAVE TË VOTIMIT PËR NJËSITË KRYESORE
DHE VULAVE PËR KIZ, KZF, TË KRYETARIT TË KZF-VE DHE TË KQV, NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

Në bazë të nenit 6, pika 2, germa e), f), të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, sot më datë 13.05.2020 Komisioni Institucional Zgjedhor,

VENDOSI:

1. Të miratojë vulën e Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ) të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë numrin e qendrave të votimit të njësive kryesore të UMT-së, përkatësisht: Fakulteti i Mjekësisë-4 QKV; Fakulteti i Mjekësisë Dentare-1 QKV; Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike – 4 QKV
3. Të miratojë vulën e Komisioneve të Zgjedhjeve të Fakulteteve (KZF), Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Fakulteti i Mjekësisë Dentare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Kryetareve për këto KZF si dhe KQV-ve, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi. Vulat të jenë në formë të rrumbullakët me diametër \varnothing 39 (fi tridhjetë e nëntë).
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në ambientet e UMT-së dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së, si dhe përcillet për zbatim strukturave përgjegjëse.

KRYETAR
SILVANA BALA

